



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Qershor, 2026

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse gjatë muajit qershor 2026
2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, forma e agreguar dhe individuale
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përf forcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT QERSHOR 2026

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar 7,008 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(437.3 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (8,861 raste apo Inc. 552.9 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Diarea ac. me 3,989 raste ose Inc. 248.9/100,000 banorë dhe Influenca sezonale (ILI) me 1,976 raste ose Inc. 123.3/100,000. (Tab.1).

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar 5 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me dg. Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 2 raste me dg. Bronchopneumonia me me diagnozë përcjellëse.

Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuar në Kosovë, qershor 2026 krahasuar me qershor 2025

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuara në Kosovë gjatë muajit qershor të vitit 2026 krahasuar me qershor 2025				
Sëmundjet /shkaktarët	Qershor 2026		Qershor 2025	
	Nr. i rasteve	Incidenca/100,000	Nr. i rasteve	Incidenca/100,000
ITPR - Pneumonia/ARI	195	12.2	849	53.0
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	23	1.4	8	0.5
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	1,976	123.3	3,254	203.1
RSV	3	0.2	4	0.2
COVID 19		0.0	1	0.1
Influenca A	27	1.7		0.0
Diarea acute	3,989	248.9	4,179	260.8
Variçela	476	29.7	340	21.2
Sindromi meningjeal	26	1.6	16	1.0
Helmimet me ushqim	63	3.9	55	3.4
Kampilobakter		0.0		0.0
Salmonella enteritidis	17	1.1	6	0.4
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale dhe me Rotavirus	11	0.7	6	0.4
Gastroenterokolitet	46	2.9	51	3.2
Hepatiti akut B		0.0	4	0.2
Hepatiti akut C	1	0.1		0.0
Morbilli	24	1.5	17	1.1
Parotiti epidemik	4	0.2	3	0.2
Pertussis	2	0.1		0.0
TB**	53	3.3	17	1.1
Tularemia		0.0		0.0
Brucelosis	4	0.2	5	0.3
Echinococcus	1	0.1		0.0
Sëmundja Lyme	8	0.5	4	0.2
Toxoplasmosis	1	0.1		0.0
Legionelloza	1	0.1		0.0
HIV/AIDS	6	0.4	3	0.2
IST	18	1.1	17	1.1
Cl.Difficile	4	0.2	3	0.2
Giardiaza	3	0.2	5	0.3
Infeksionet streptokoksike të grupit A	19	1.2		0.0
*Sëmundjet tjera ngjitëse	7	0.4	14	0.9
Gjithsej	7,008	437.3	8,861	552.9

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, QERSHOR 2026

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

Diarea akute: Gjatë muajit qershor 2026 në IKShPK janë raportuar 3,989 raste me Diare akute (Inc.248.9/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,179 raste), vërehet ulje prej 4.5% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, me 3,188 raste të raportuara, rritje prej 25.13% e numrit të rasteve të raportuara. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë dhe kushteve të ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit qershor 2026 në IKShPK janë raportuar 1,976 raste me ILI (Inc. 123.3/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet një ulje prej 39.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (3,254 raste të raportuara). Gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, maj 2026 me (3,349 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje prej 41% e numrit të rasteve të raportuara.

ARI/ITPR: Gjatë muajit qershor 2026 në IKShPK janë raportuar 195 raste me ARI (Inc.12.2/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (849 raste) vërehet ulje prej 77% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak maj 2026 me (488 raste) vërehet ulje për 60%. Numri i rasteve të raportuara lidhet me ecurinë sezonale të infeksioneve respiratore.

Variçella: Gjatë muajit qershor 2026 në IKShPK janë raportuar 476 raste me Variçellë (Inc.29.7/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (340 raste) vërehet rritje prej 40% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak maj 2026 me 528 raste të raportuara, rënie prej 9.8% e numrit të rasteve të raportuara.

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit qershor, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) është vërejtur një rritje e numrit të rasteve të raportuara me fruth. Gjatë kësaj periudhe janë raportuar gjithsej 69 raste të dyshimta, të mundshme prej të cilave 24 raste janë konfirmuar me laborator. Sipas të dhënave epidemiologjike, 20 raste (83.3%) të konfirmuara nuk janë të vaksinuara me vaksinën MMR. Numri më i lartë i rasteve është raportuar nga komuna e Prishtinës me 8 raste (33.3%), pasuar nga komuna e Ferizajit me 4 raste, komuna e Fushë Kosovës dhe e Vushtrrisë me nga 2 raste si dhe me nga 1 rast komuna: Kaçanikut, Lipjanit, Shtimes, Deçanit, Vitisë, Drenasit, Podujevës dhe Obiliqit. Sipas grup-moshave, 10 raste i përkasin grup-moshës 12-24 muaj, 9 raste grup-moshës 0-12 muaj, 2 raste grup-moshës 2-4 vjeç ndërsa 3 raste grup-moshës mbi 18 vjeç.

Gjatë muajit qershor nga grupi i sëmundjeve vaksinëparandaluese janë raportuar gjithashtu 4 raste me parotit dhe 2 raste me pertussis. Rastet me parotit, sipas komunave, 2 raste i takojnë komunës së Prishtinës dhe me nga 1 rast komunat: Gjakovë dhe të Gjilan. Sipas grup-moshës 2 raste i takojnë grup-moshës 1-4 vjeç, 1 rast i takon grup-moshës 5-9 vjeç, dhe 1 rast grup-moshës mbi 18 vjeç. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhëna se 2 prej tyre kanë status të rregullt vaksinal. Rastet me Perussis janë raportuar nga komuna e Gjakovës (2 raste) dhe status jo të rregullt vaksinal.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë muajit qershor, nga laboratori i Mikrobiologjisë (IKShPK), janë raportuar 4 raste pozitive me Brucelozë. Sipas komunave: Ferizaj (2 raste), Malishevë dhe Shtime me nga 1 rast. Sipas grup moshave; 10-19 vjeç, 20-29 vjeç, 30-39 dhe 40-49 me nga 1 rast dhe sipas gjinisë, të gjitha rastet i takojnë gjinisë mashkullore.

Nga të dhënat e hulumtimit epidemiologjik rezultojnë se tre nga rastet kanë pasur kontakt direkt me kafshë apo konsum të produkteve, pra manipulimit me lindjet apo abortet pa masa mbrojtëse, si dhe konsumimi i produkteve të qumështit të papasterizuara, mbeten faktorët kryesorë të rrezikut për infeksion me Brucelozë.

Nga zoonozat tjera gjatë kësaj periudhe është raportuar 1 rast me Echinococcus. Sipas komunave: rasti i raportuar është nga komuna e Vitisë, grup-moshës 0-9 vjeç dhe është i gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit qershor 2026, nga sëmundjet që barten me vektorë janë raportuar 8 raste të konfirmuara me Borreliozë (IgM pozitiv). Sipas komunave: Prishtinë (5 raste), Gjilan, Pejë dhe Prizren (me nga 1 rast).

Sipas grup moshës, me nga 2 raste nga grup mosha 0-9 dhe 40-49 vjeç, dhe me nga 1 rast nga grup mosha: 20-29, 30-39, 50-59 dhe 60-69 vjeç. Sipas gjinisë, 4 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 4 raste gjinisë femërore.

Sipas hulumtimit epidemiologjik, shumica e rasteve raportojnë për histori të pickimit nga insektet para fillimit të simptomave. Nuk është evidentuar ndonjë lidhje epidemiologjike ndërmjet rasteve. Rasteve u janë dhënë rekomandime për shmangien e ekspozimit ndaj rriqrave, përdorimin e veshjeve mbrojtëse gjatë qëndrimit në natyrë, aplikimin e repelentëve, kontrollimin e trupit pas qëndrimit në zona dhe në rast pickimi, konsultimet me profesionisti shëndetësor gjatë largimit të rriqrës.

Gjatë muajit qershor 2026 është raportuar një (1) rast i konfirmuar me Legionelozë. Rast nga fshati Damanek, komuna e Drenasit, ≥65 vjeç e gjinisë femërore. Rasti është referuar si pneumoni interstiale me manifestime klinike të vështirësisë në frymëmarrje, kollitjes, barkqitjes, lodhjes dhe dhimbjeve muskulore. Fillimisht është trajtuar në Klinikën e Pulmologjisë, ndërsa pas konfirmimit laboratorik është transferuar në Klinikën Infektive, ku është hospitalizuar në gjendje mesatarisht të rëndë dhe me nevojë për ventilim artificial. Gjatë hulumtimit epidemiologjik janë mbledhur të dhëna për ekspozimin ndaj sistemeve të ujit, sistemeve të ventilimit, objekteve hoteliere, banjave termale, institucioneve shëndetësore, udhëtimeve dhe kontakteve të ngushta. Rasti deklaroi përdorimin e ujit nga bunari për punë në oborr dhe herë pas here për pije, përdorimin e ujit nga rrjeti i ujësjellësit dhe ujit të ambalazhuar, si dhe posedimin e një kondicioneri shtëpiak, i cili pastrohet periodikisht. Gjatë periudhës së inkubacionit nuk ka raportuar qëndrim në hotele, banja termale, qendra rehabilitimi apo ekspozime të tjera të njohura me rrezik për legionelozë.

Sindroma meningjeale

Gjatë muajit qershor, 2026 janë raportuar gjithsej 26 raste me Sindromën Meningjeale (*Mb. 1.62/100,000 banorë*), prej tyre 24 raste me Dg. Meningitis Acuta dhe 2 raste me Dg. Meningoencephalitis. Numri i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak (qershor, 2025), ku ishin raportuar 16 raste (*Inc. 0.90/100,000 banorë*). Numri më i madh i rasteve të raportuara sipas komunave është regjistruar në Prishtinë me 9 raste, pastaj duke vazhduar me 3 raste nga Fushë-Kosova, me nga 2 raste komunat: Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Malishevë dhe Vushtrri dhe me nga 1 rast në komunat: Podujevë, Shtime, Skenderaj dhe Hani i Elezit. Sa i përket shpërndarjes sipas grup moshës, gjatë kësaj periudhe numri më i madh i rasteve është raportuar në grup-moshën 0-9 vjeç me 16 raste (62%), pastaj grup moshë 10-19 vjeç me 4 raste (15%), grup moshat 20-29 vjeç dhe 30-39 vjeç, me nga 2 raste (8%) dhe grup moshat, 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 1 rast (4%). Ndërsa, nuk ka raportime nga grup moshat tjera. Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, 23% (6 raste) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 77% (20 raste) i takojnë gjinisë mashkullore. Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKSHPK përmes sistemit MedLIS, si dhe në laboratorin mikrobiologjik të Klinikës Infektive, janë identifikuar disa shkaktarë viralë dhe bakterial në lëngun cerebrospinal (LCS). Gjithsej janë raportuar 9 raste me izolime pozitive.

Shkaktarët viralë të identifikuar janë: 3 raste me Human Enterovirus, 2 raste me HHV7 dhe 1 rast me HSV-1. Ndërsa nga shkaktarët bakterial janë identifikuar me nga 1 rast me *Neisseria meningitidis*, *Streptococcus pneumoniae* dhe *Acinetobacter baumani*. Nga rastet e raportuara gjatë muajit qershor, 2026, nuk është raportuar vdekje me Sindromën Meningjeale.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit qershor 2026, krahas sëmundjeve që raportohen në formën e agreguar janë raportuar gjithashtu edhe 63 raste me Helmim me ushqim dhe 46 raste me Gastroenterokolit.

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive janë raportuar: 17 raste të konfirmuara me *Salmonella enteridis* (shih seksioni epidemitë e raportuara në Kosovë). Sipas komunave; 7 raste nga komuna e Prishtinës, komunat: Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Hani i Elezit me nga dy raste të raportuara, dhe me nga një rast komunat: Podujevë, Mitrovicë, Klinë dhe Ferizaj. Sipas grup moshës: 9 raste nga grup moshë 0-9 vjeç, dhe me nga dy raste nga grup moshat 10-19 vjeç, 20-29 vjeç, 30-39 vjeç dhe 60-69 vjeç. Sipas gjinisë 10 raste të gjinisë mashkullore dhe 7 raste të gjinisë femërore; Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë raportuar 6 raste me Rotavirus. Sipas komunave: 2 raste nga komuna e Prishtinës, dhe me nga një rast komunat: Gjakovë, Deçan, Rahovec dhe Mitrovicë. Sipas grup moshës: 4 raste nga grup-moshë 0-9 vjeç dhe dy raste nga grup moshë 10-19 vjeç. Sipas gjinisë: 3 raste të gjinisë femërore; 3 raste me *Giardia lamblia*. Sipas komunave: me nga një rast paraqiten komuna e Klinës, Gjakovës dhe komuna e Prizrenit. Sipas grup-moshave: me nga një rast paraqiten grupëmoshat 0-9 vjeç, grupëmosha 20-29 vjeç dhe grupëmosha mbi 60 vjeç; 4 raste me *Clostridium difficile*. Sipas komunave: të gjitha rastet i përkasin komunës së Prishtinës. Sipas grupmoshës: me nga 2 raste paraqiten grupëmoshat 20-29 vjeç dhe grupëmosha 30-39 vjeç. Sipas gjinisë: me nga 2 raste paraqiten gjinia femërore dhe gjinia mashkullore; 5 raste me Adenovirus. Sipas komunave: me nga dy raste të raportuara nga komuna e Prishtinës dhe Gjakovës, dhe me një rast nga komuna e Podujevës. Sipas grup moshës: 4 raste të grup moshës 0-9 vjeç dhe një rast i grupmoshës 10-19 vjeç. Sipas gjinisë: tre raste i përkasin gjinisë mashkullore dhe dy raste i përkasin gjinisë femërore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit qershor 2026, janë testuar gjithsej 218 mostra të dyshimta për Influcencë dhe patogjenë të tjerë respiratorë dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast me Influcencë A, Influcencë B apo SARS-CoV-2. Nga patogjenët e tjerë respiratorë janë raportuar 3 (1.38%) mostra pozitive me RSV, 27 (12.39%) mostra pozitive me Human Rhinovirus, 11 (5.05%) mostra pozitive me Human Adenovirus, 2 (0.92%) mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 14 (6.42%) mostra pozitive në Human Parainfluenza virus. (*Grafikoni 1*). Rastet pozitive me virusin sincicial respirator (RSV), sipas komunave gjatë muajit qershor 2026, janë raportuar në Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Skenderaj. Sipas grup-moshës, të tri rastet i përkasin grup-moshës 0-4 vjeç, ndërsa sipas gjinisë, të tri rastet i përkasin gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit qershor 2026, përmes raportimit në kohë reale nga Kl. Infektive, Kl. E Pediatriisë, Kl. E Pulmologjisë dhe përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), u raportuan gjithsej 23 raste me SARI. Prej tyre 14 apo 60.8% nuk u testuan në asnjë nga viruset respiratore ndërsa 9 apo 39.1% prej tyre, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan, 1 mostër pozitive në Human Rhinovirus, 1 mostër pozitive në Human Adenovirus, 1 mostër pozitive në Human Metapneumovirus dhe 1 mostër pozitive në Parainfluenza Virus. Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (10 raste), Fushë Kosovë (6 raste), Ferizaj (4 raste), Mitrovicë (3 raste), Lipjan (2 raste), Podujevë (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Gjakovë, Malishevë, Obiliq, Rahovec dhe Vushtrri. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (13 raste), 0-4 vjeç (4 raste), 15-34 vjeç (2 raste), 35-50 vjeç (2 raste) dhe 51-64 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë, 14 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 9 gjinisë femërore. Nga të gjitha rastet SARI, 7 apo 30.4% prej tyre ishin të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Gjatë muajit qershor 2026, janë raportuar 4 raste të vdekjes nga SARI (CFR= 17.4%). Rastet e vdekjes nga SARI i takojnë grup-moshës 65+, 2 të gjinisë femërore dhe 2 të gjinisë mashkullore, nga komunat: Prishtinë (2 raste) dhe me nga një rast Lipjan dhe Rahovec, me sëmundje përcjellëse dhe vetëm njëri prej tyre është i vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal.

Ecuria me Tuberkuoz

Në SMSN, gjatë muajit qershor 2026, janë raportuar 41 raste me Tuberkuoz apo 2.55 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (10 raste), Ferizaj (8 raste), Gjakovë (5 raste), Gjilan (4 raste), Podujevë (3 raste), Drenas dhe Shtime me nga (2 raste), kurse me nga 1 rast komunat: Pejë, Hani i Elezit, Obiliq, Lipjan, Skenderaj, Istog dhe Viti. Prej 53 rasteve të raportuara, 28 (68.2%) janë raste pulmonare dhe forma ekstra-pulmonare 13 (31.7%). Sa i përket grup-moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultoi se grup-moshat më të prekura janë grup-moshat 20–29 vjeç (12 raste), 60–69 vjeç (8 raste), grup-moshat 75–79 vjeç (7 raste), grup-moshat: 30–39 vjeç, 40–49 vjeç dhe 55–59 vjeç me nga (4 raste), mbi 80 vjeç (3 raste), kurse 10–19 vjeç me (0 raste). Sipas gjinisë, rezultoi se 51.2% (21 raste) i takojnë gjinisë mashkullore ndërsa gjinia femërore me 48.7% (20 raste).

Rastet me HIV/AIDS/IST, qershor 2026

Gjatë muajit qershor 2026, janë raportuar 6 raste me HIV/AIDS. Sipas gjinisë, 4 raste janë të gjinisë mashkullore dhe dy të gjinisë femërore. Sipas komunave: 4 raste nga komuna e Prishtinës dhe nga një rast nga Istogu dhe Vushtrria. Sipas grup moshës, 4 raste i përkasin grup moshës 25-34 vjeç dhe me nga një rast grup moshë: 15-24 vjeç dhe 45-54 vjeç.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), qershor 2026

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar gjithsej 18 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 5, Prishtinë 3, Prizren 2, Kaçanik 2, dhe me nga një (1) rast komunat Suharekë , Pejë , Viti , Obiliq , Rahovec dhe Malishevë. Sipas diagnozës: Condyloma 6, Chlamydia 9 raste, Sifiliz 1 rast, Gonorrhea 1 rast dhe HPV 1 rast. Sipas gjinisë: 11 raste (61,11%) i takojnë gjinisë femërore dhe 7 raste (38,88%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 15-24 vjeç 0 raste (0%), 25-49 vjeç 14 raste (75%) dhe 50+ 4 raste (25%).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C

Gjatë muajit qershor, 2026 nuk është raportuar asnjë rast me Dg. Hepatit akut B, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ku janë raportuar 4 raste me Hepatit akut B (Mb. 0.22/100 000 banorë). Sa i përket Hepatitit akut C, gjatë muajit qershor, 2026 është raportuar 1 rast (Mb. 0.06/100 000 banorë), i gjinisë mashkullore, i moshës 30 vjeçare nga komuna e Fushë-Kosovës. Në të njëjtën periudhë të vitit 2025 nuk është raportuar asnjë rast me Dg. Hepatit akut C. Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast vdekje me Hepatit akut B ose C.

Tabela 2. Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, qershor 2026

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, qershor _2026																																
SËMUNDJA	Pneumo nia/ARI	SARI	ILI	Diarrhe a ac	Variçell a	Influenc a A	RSV	Sindroma meningjeale		Morbilli	Parotiti s epidemi ca	Pertussi s	Hepatit ac. C	Helmin et me ushqim	Gastroe nterokol itet	Brucelo za	Salmon elloza	Rotavir us	Borelioz a (Lyme Disease)	Legionel la	Adenovi rus	Toxopla zmoza	Echinoc occus	Cl.diffici le	IST	HIV	TB	Giardiaz a	Infeksio net streptok oksike të gr. A	Sëm.tjer a ngjitëse	Githsej	
KOMUNA								Meningj it serosa	Mening enceph alit ac.																							
DEÇAN	4		29	67	6	6		2		1								1												2	118	
DRAGASH	4		16	44											3																67	
DRENAS		1	16	58	14					1					3					1								3			97	
F. KOSOVË	5		28	91	17		1	3		2			1		1		2													1	152	
FERIZAJ	14	2	131	212	17			2		4					9	2	1								5		8				407	
GJAKOVË	8		45	84	38			2			1	2						1			2						5	1	14		203	
GJILAN	1		46	124	18						1								1									4			195	
GRAÇANICË															3					1											3	
H. I ELEZIT	2		20	51	15				1						1		2											1			93	
ISTOG	4		51	80										6												1	1				143	
JUNIK				14										1																	15	
KACANIK	6		61	84	16					1					2										2						172	
KAMENICË	0		52	38																							1				91	
KLINË	11		41	66	10	10									3		1												1		143	
KLOKOT																															0	
LEPOSAVIQ															1																1	
LIPJAN		1	25	12	4					1					1												1			1	46	
MALISHEVË			26	37	2			2								1						0			1						69	
MAMUSHË	0		2	15																											17	
MITROVICË	17		145	365	15									9			1	1												1	2	556
MITROVICË E VERIUT																																
N. BËRDË			16	7																											0	
OBILIQ	1	1	16	64	11					1															1		1				23	
PARTESH																															0	
PEJË	27		340	361	11	11								23					1						1		1				776	
PODUJEVË	4	1	31	64	14			1		1					16		1				1						3				137	
PRISHTINË	71	10	357	1037	175		1	8	1	8	2				1		7	2	5		2			4	3	4	10			1	1709	
PRIZREN	1	1	135	364	26									5					1			1			2		7	1		3	547	
RAHOVEC		1	15	38	8														1						1		2				66	
RANILLUG																															0	
SHTËRPCE																															0	
SHTIME	5	1	126	116	14			1		1					1	1											2				268	
SKËNDERAJ	4		23	62	21		1	1																			1			1	114	
SUHAREKË	3	1	138	270	6																				1		1				420	
VITI	0	1	43	89	15					1					4								1		1		1				156	
VUSHTRRI	3	2	2	75	3			2		2				16			2										1				108	
Z. POTOK																															0	
ZVEÇAN																															0	
PA ADRESË																															0	
GJITHSEJ	195	23	1,976	3,989	476	27	3	24	2	24	4	2	1	63	46	4	17	6	8	1	5	1	1	4	18	6	53	3	19	7	7,008	
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza																																

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, QERSHOR 2026

Gjatë kësaj periudhe janë raportuar 408 raste të hospitalizuara si pasojë e sëmundjeve ngjitëse. Numri më i madh i rasteve të hospitalizuara siç shihet në tabelën nr.3 është raportuar nga diarretë akute dhe gastroenterokolitet, të pasuara nga pneumonitë dhe infeksionet viraledhe bakteriale të traktit respirator. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa rastet tjera raportohen sipas pasqyrës klinike (shih Tabela 3).

Tabela 3. Rastet e hospitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatriisë dhe spitalet e përgjithshme, qershor 2026

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	85
SARI	23
Sindroma meningjeale	26
Helmimet me ushqim	17
Diarea akute dhe gastroenterocolite	235
Status febrilis	26
Exanthema	2
Mononucleosis	3
Erysipela	8
Gjithsej	408

4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT QERSHOR 2026

Epidemia alimentare me *Salmonella enteritidis* në rajonin e Prishtinës

Më datë 12.06.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Prishtinë ka raportuar epidemi alimentare me diagnozë Intoxicatio alimentaris (A05) në një lokal ushqimor në rajonin e Prishtinës në rajonin e Prishtinës. Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë daton më 09.06.2026, ndërsa rastet e para janë paraqitur më 10.06.2026. Bazuar në hulumtimin epidemiologjik, kanë qenë 80 persona të ekspozuar, prej të cilëve 3 kanë zhvilluar simptomatologji klinike dhe kanë kërkuar trajtim spitalor. Nuk janë raportuar raste fatale. Shkalla e sulmit (Attack Rate – AR) është 3.75% (3/80). Për qëllime diagnostike dhe epidemiologjike janë marrë gjithsej 3 mostra ushqimore dhe 3 mostra fecesi nga rastet e dyshuara. Shkaktari etiologjik është konfirmuar *Salmonella enteritidis* nga mostrat e fecesit të dy rasteve të hospitalizuara, ndërsa në mostrën ushqimore është izoluar *Salmonella* spp.. Rezultatet laboratorike kanë qenë në përputhje me të dhënat epidemiologjike. Rastet e raportuara kanë manifestuar simptomatologji karakteristike për helmim alimentar, si temperaturë, ethe, të vjella dhe diarre. Sipas gjinisë, 2 raste i përkasin gjinisë mashkullore dhe 1 rast gjinisë femërore. Sipas grupmoshës, janë përfshirë: 0–4 vjeç me 1 rast, 25–29 vjeç me 1 rast dhe 30–34 vjeç me 1 rast.

Epidemia alimentare e dyshuar në rajonin e Prishtinës

Më datë 18.06.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Prishtinë ka raportuar epidemi alimentare me diagnozë Intoxicatio alimentaris (A05) në rajonin e Prishtinës. Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë daton më 15.06.2026, ndërsa rastet e dyshuara janë paraqitur pas konsumimit të ushqimit në një subjekt ushqimor në rajonin e Prishtinës. Informata për paraqitjen e rasteve është pranuar përmes bashkëpunimit me Inspektoriatin Sanitar dhe strukturat relevante institucionale. Bazuar në hulumtimin epidemiologjik, janë identifikuar 8 persona të ekspozuar, prej të cilëve 1 rast ka kërkuar trajtim mjekësor, ndërsa 7 persona të tjerë kanë raportuar simptomatologji të ngjashme, me ekspozim të përbashkët dhe lidhje epidemiologjike me rastin e raportuar. Burimi i infeksionit është vlerësuar i dyshuar, ndërsa rruga e transmetimit është identifikuar si alimentare, përmes konsumimit të ushqimit të kontaminuar. Për qëllime diagnostike dhe epidemiologjike janë marrë gjithsej 5 mostra ushqimore dhe 10 strisho nga ambienti i punës dhe stafi. Nga analizat mikrobiologjike të mostrave ushqimore nuk është izoluar asnjë shkaktar patogjen, gjithashtu as nga strishot e marra nga ambienti i punës dhe stafi nuk janë izoluar baktere patogjene. Rastet e raportuara kanë manifestuar simptomatologji karakteristike për helmim alimentar, si: ethe, temperaturë, dhimbje barku, të vjella dhe diarre. Sipas shpërndarjes sipas gjinisë, gjashtë nga rastet e i përkasin gjinisë femërore dhe dy gjinisë mashkullore. Bazuar në të dhënat epidemiologjike, rastet kanë pasur ekspozim të përbashkët, fillim të ngjashëm të simptomave pas konsumimit të ushqimit dhe lidhje të qartë epidemiologjike ndërmjet tyre, duke mbështetur dyshimin për një ngjarje alimentare.

5. RAPORTIMI I SËMUNDJEVE NGJITËSE NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PËRMES SMSN KRAHASUAR ME ATE ME KOPJE FIZIKE, QERSHOR 2026

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 28 komuna ose 73.68% (28/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok. Nga komunitat me shumicë serbe përveç Novo Bërdës, të gjitha komunitat e cekura më lartë, gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, qershor 2026

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) ka mandat monitorimin e situatës epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në vend dhe këtë e bënë përmes Sistemit digjital të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN).

Megjithatë, raportimi i rasteve në SMSN nga ana e institucioneve shëndetësore ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 28 komuna ose 73.68% (28/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok. Nga komunitat me shumicë serbe përveç Novo Bërdës, të gjitha komunitat e cekura më lartë, gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

Bazuar në Sistemin e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse për periudhën 01/06/2026-30/06/2026, sipas panelit (sidebar) për monitorim të institucioneve raportuese, shprehur sipas indikatorit është: 135 institucione kanë raportuar karahasuar me 487 institucione të obligueshme për raportim (apo shprehur në përqindje 27.7%). Ndërsa sipas përlogaritjes së të dhënave nga Departamenti i Epidemiologjisë në IKSHPK, për muajin qershor 2026 janë raportuar gjithsej 7,008 raste me sëmundje ngjitëse. Prej tyre, 4,442 raste të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë përmes kopjeve fizike të formularit të raportimit ndërsa përmes SMSN janë raportuar 2,566 raste apo shprehur në përqindje (36.6%) nga numri i përgjithshëm i rasteve. (Tabela 4).

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, qershor 2026

Qershor 2026, përmes kopjes fizike											Qershor 2026, përmes SMSN											
KOMUNA	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucio net Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Njësia Shëndetësore e Burgjeve	Institucio net Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
DEÇAN							84	5		89									11			11
DRAGASH							61	8		69									1			1
DRENAS							19			19									36	10		46
F. KOSOVË										0									116	31	68	215
FERIZAJ	12					260	34	75		381	2						8		31	7		48
GJAKOVË										0	32						22		102	53		209
GJILAN	1					23	11	145	11	191	14						1		18	43		76
GRAÇANICË										0												0
H. I ELEZIT							64			64									31			31
ISTOG							94	22		116									6			6
JUNIK										0									24			24
KAÇANIK							126			126									33			33
KAMENICË							17	73		90									35	15		50
KLINË							105			105							1		5			6
KLOKOT										0												0
LEPOSAT										0												0
LIPJAN										0									29	3	8	40
MALISHEVË										0									65	1		66
MAMUSHË										0									21			21
MITROVICË	42	8	251	4			160	44		509									19	8		27
MITROVICË V.										0												0
N. BËRDË							23			23									2			2
OBILIQ										0									71	12	4	87
PARTESH										0												0
PEJË	4					2	164	384	87	641	90								43			133
PODUEVË										0									96	14		110
PRISHTINË		72	85				99	178	152	586		48	7	3	1	2	5	11	36	690	5	808
PRIZREN	91					15	203	208	16	533	71					1	16		67	102		257
RAHOVEC										0							9		28	28		65
RANILLUG										0												0
SHTËRPCE										0												0
SHTIME							10	238		248									14			14
SKËNDERAJ							50	36		86									17	7	0	24
SUHAREKË						33	286	96	3	418							4		8	1		13
VITI							94	54		148									33	6		39
VUSHTRRI										0	32								31	40	1	104
Z. POTOK										0												0
ZVEÇAN										0												0
Gjithsej	150	80	336	4	0	333	1704	1566	269	4442	241	48	7	3	1	3	66	11	1029	1071	86	2566

6. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, QERSHOR 2026

Ebola

Gjatë muajit qershor 2026, shpërthimi i sëmundjes nga virusi Ebola i shkaktuar nga Bundibugyo virus vazhdoi të zgjerohej në Republikën Demokratike të Kongos (RDK), ndërsa në Ugandë situata epidemiologjike mbeti relativisht stabile. Deri më 24 qershor janë raportuar 1.155 raste të konfirmuara, përfshirë 304 vdekje në RDK, ndërsa 385 pacientë kanë qenë të hospitalizuar në izolim. Shumica e rasteve janë raportuar në provincën Ituri, ndërsa raste janë evidentuar edhe në North Kivu dhe South Kivu. Në Ugandë janë raportuar gjithsej 20 raste të konfirmuara, përfshirë dy vdekje, ku shumica kanë qenë të lidhura epidemiologjikisht me RDK, ndërsa janë regjistruar edhe raste të transmetimit lokal. Gjatë muajit është raportuar edhe rasti i parë i importuar në Francë tek një punonjës shëndetësor i kthyer nga RDK, me zbatim të menjëhershëm të izolimit dhe gjurmimit të kontakteve. Sipas ECDC, rreziku për popullatën e përgjithshme në vendet e BE/ZEE mbetet shumë i ulët, megjithëse mbetet i nevojshëm monitorimi i vazhdueshëm për shkak të përhapjes aktive të shpërthimit dhe mungesës së vaksinave dhe trajtimeve specifike të licencuara kundër virusit Bundibugyo.

MPOX

Virusi Mpox (kladet I dhe II) vazhdoi të qarkullojë në vendet e BE/ZEE dhe në nivel global edhe gjatë muajit qershor 2026. Sipas raportit mujor të ECDC-së, gjatë muajit maj janë raportuar 94 raste të kladës I dhe 22 raste të kladës II në vendet e BE/ZEE, duke treguar rënie krahasuar me muajin prill. Shumica e rasteve vazhdojnë të raportohen tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj, ndërsa paraqitja klinike ka qenë kryesisht e lehtë dhe hospitalizimet kanë mbetur të kufizuara. Në nivel global, transmetimi i të dy kladeve vazhdon në disa kontinente, ndërsa rastet e importuara dhe transmetimi lokal vazhdojnë të evidentohen edhe jashtë Afrikës. Me afrimin e sezonit veror dhe rritjen e udhëtimeve ndërkombëtare dhe grumbullimeve masive, ECDC vlerëson se ekziston potencial për transmetim të mëtejshëm. Rreziku për infeksion me kladën Ib mbetet mesatar për grupet me rrezik të lartë dhe i ulët për popullatën e përgjithshme, ndërsa për kladën IIb mbetet i ulët.

Patogjenët respirator

Gjatë muajit qershor 2026, aktiviteti i viruseve respiratore në vendet e BE/ZEE ka mbetur në nivele të ulëta ndër-sezonale. Aktiviteti i Influcencës, SARS-CoV-2 dhe virusit sincicial respirator (RSV) ka vazhduar të ulët si në kujdesin parësor ashtu edhe në mbikëqyrjen epidemiologjike spitalore, duke reflektuar përfundimin e sezonit respirator. Sipas ECDC-së, megjithëse situata epidemiologjike mbetet e qetë, monitorimi i vazhdueshëm laboratorik dhe epidemiologjik mbetet i rëndësishëm për identifikimin e hershëm të ndryshimeve në qarkullimin e viruseve respiratore dhe shfaqjen e varianteve të reja.

Virusi i Nilit Perëndimor (WEST NILE VIRUS)

Gjatë muajit qershor 2026 ka filluar sezoni i mbikëqyrjes epidemiologjike për infeksionet me Virusin e Nilit Perëndimor. Deri më 24 qershor janë raportuar tre raste humane në Evropë, nga Italia dhe Maqedonia e Veriut. Sipas ECDC-së, kushtet klimatike sezonale janë të favorshme për aktivitetin e mushkonjave, prandaj pritet rritje graduale e rasteve gjatë muajve të verës. Monitorimi epidemiologjik dhe zbatimi i masave për sigurinë e gjakut mbeten prioritare gjatë gjithë sezonit.

Ethet Hemorragjike Krime–Kongo (EHKK)

Gjatë muajit qershor 2026 është raportuar një rast autokton i etheve hemorragjike Krime-Kongo në Spanjë. Sipas ECDC-së, rasti është në përputhje me modelin sezonal të sëmundjes dhe lidhet me rritjen e aktivitetit të rriqrave të gjinisë *Hyalomma*, të cilët janë vektorët kryesorë të virusit. Rreziku për popullatën e përgjithshme mbetet i ulët, ndërsa është më i lartë për personat që ekspozohen ndaj pickimeve të rriqrave gjatë aktiviteteve profesionale ose rekreative në natyrë.

Ethet Denge

Gjatë muajit qershor 2026 është raportuar vazhdimi i qarkullimit global të virusit të dengës, me mbi 1 milion raste dhe mbi 1.000 vdekje të raportuara deri më 22 qershor në më shumë se 80 vende. Megjithëse numri global i rasteve mbetet i lartë, ai është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Në vendet e BE/ZEE nuk janë raportuar raste autoktone, përjashtuar disa rajone ultraperiferike. ECDC vlerëson se kushtet klimatike në Evropë tashmë favorizojnë aktivitetin e mushkonjave Aedes, duke rritur mundësinë e transmetimit lokal pas importimit të rasteve nga udhëtarët. Gjithashtu, është vërejtur rënie e rasteve të importuara tek udhëtarët e kthyer nga Maldive krahasuar me muajt e mëparshëm.

Chikungunya

Gjatë muajit qershor është vërejtur rënie e rasteve të importuara të Chikungunyas në vendet e BE/ZEE tek udhëtarët e kthyer nga Seychelles. Megjithatë, për shkak të aktivitetit sezonal të mushkonjave kompetente në Evropë, ECDC vlerëson se ekziston mundësia e paraqitjes së rasteve autoktone gjatë muajve të verës pas importimit të virusit. Vazhdon të rekomandohet zbatimi i masave parandaluese kundër pickimeve të mushkonjave dhe vlerësimi i vaksinimit sipas rekomandimeve kombëtare

Kolera

Kolera vazhdoi të paraqesë problem të rëndësishëm të shëndetit publik në disa vende të Afrikës, Azisë dhe Amerikës gjatë muajit qershor. Midis 26 majit dhe 22 qershorit janë raportuar 19.659 raste të reja dhe 261 vdekje, ndërsa që nga fillimi i vitit 2026 janë regjistruar 105.813 raste dhe 1.216 vdekje në nivel global. Numri më i madh i rasteve është raportuar në Nigeri dhe Republikën Demokratike të Kongos. Në vendet e BE/ZEE kolera mbetet sëmundje e rrallë dhe rastet vazhdojnë të lidhen kryesisht me udhëtimet në zona endemike. Sipas ECDC-së, rreziku për udhëtarët mbetet i ulët, megjithëse importimi sporadik i rasteve mbetet i mundur.

Gripi Avian

Gjatë muajit qershor është raportuar një rast i ri human i Influençës Aviane A(H9N2) në Kinë tek një fëmijë nën pesë vjeç. Infeksioni lidhej me ekspozimin ndaj shpendëve të infektuar ose mjediseve të kontaminuara. Sipas ECDC-së, infeksionet humane me këtë virus vazhdojnë të jenë sporadike, me ecuri klinike kryesisht të lehtë dhe pa dëshmi për transmetim të qëndrueshëm nga njeriu te njeriu. Rreziku për popullatën e përgjithshme në vendet e BE/ZEE mbetet shumë i ulët.

Virusi Zika

Në Maqedoninë e Veriut është raportuar një rast i konfirmuar i infeksionit me virusin Zika. Sipas hetimit epidemiologjik, rasti ka histori udhëtimi në ishullin Maafushi, Maldive, ku ka qëndruar gjatë periudhës 20–28 maj 2026 dhe ka raportuar ekspozim ndaj pickimit të mushkonjës gjatë qëndrimit. Shenjat e para të sëmundjes janë shfaqur më 24 maj 2026, me ethe, dhimbje muskulore dhe artikulare, ndërsa katër ditë më vonë është zhvilluar skuqje makulopapulare me elemente petekiale në abdomen dhe shpinë, e shoqëruar me enantemë. Rasti nuk ka kërkuar hospitalizim dhe është trajtuar në kushte shtëpiake, me ecuri të favorshme klinike dhe gjendje të mirë të përgjithshme. Bazuar në të dhënat epidemiologjike, infeksioni konsiderohet rast i importuar dhe nuk ka dëshmi për transmetim lokal. Autoritetet shëndetësore kanë vazhduar monitorimin epidemiologjik, ndërsa situata në rajon mbetet stabile dhe nën mbikëqyrje epidemiologjike të vazhdueshme.

7. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>

E-mail: QOE.IKSHP@rks-gov.net

Telefoni+38338 541432

